

„Kur merr PUSHTETIN, mos mblidh rreth veshes njerëz të këqinj dhe të paaftë,
se për tërë dështimet do të akuzojnë Ty.“

SOLONI

Njoftim!
Faqe INTERNETI
Gazeta “Korça”
+ Suplement “Vëzhguesi”
www.rda-korca.org

2
0
1
0

Janar						
H	M	M	E	P	S	D
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

Korça

Nëse një shoqëri demokratike nuk ndihmon shumicën, që janë të varfërit, nuk mund të shpëtojë pakicën që janë të pasurit.

J.F.Kenedy-Ish President i SHBA

Gazetë e pavarur: Social patriotike, letrare, kulturore-artistike, satirike, humoristike, sportive.

e përmuajshme

Nr. 165 janar 2010

Çmimi 30 lekë

1 Euro

e-mail gazetakorca@yahoo.co.uk

Internet:www.gazetakorca.com

DËBORA E PARË NË KORÇË



*Palë, palë, bie borë,
Korça, nuse vetull kurorë.
Nur ke në pranverë,
vjeshhtë,
e verë.
Por bukuri
ke dhe me
thinjat
flokë dëborë.*



U MBLODH SHTABI I EMERGJENCËS PRANË INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT

-U mbledh shtabi i emergjencës për situatën në rajonin e Korçës nën drejtimin e Prefektit të Qarkut Korçë Z.Koço Bello.

-Mernin pjesë drejtorët e institucioneve shtetërore, përfaqësues nga biznesi, shoqëria civile dhe Media e shkruar rajonale dhe ajo radio televizive publike dhe private.

-Z.Bello ka kërkuar nga të pranishmit një gadishmëri dhe solidaritet për monitorimin e situatës (është rritur kuota në lumin Devoll e Dunavec si rezultat i shirave të rënë ditët e fundit), sidomos në akset rrugore, rezervuarët, kanalet kulluese, emergjencat për shkarje dheu, etj, sipas situatës që do të paraqitet në vazhdim.....

-Në këtë takim Prefekti Bello ka shprehur solidaritetin dhe mbështetjen, jo

vetëm morale, por dhe materiale për banorët që rezikohen nga përmytjet e reshjeve të shiut në veri të vendit. Institucioni i Prefektit me kontributin financiar të punonjësve të tij ka vënë në dispozicion 450.000 lek në Nr. e llogarisë të çelur nga Qeveria shqiptare.

Gjithashtu Ai ka bërë apel për të gjithë njësitë e qeverisjes vendore të Qarkut të Korçës, për të kontribuar financiarisht nga fondi rezervë i tyre për zbutjen e fatkeqësisë të banorve të zonës veriore të vendit.

Ai ju bëri thirrje dhe biznesit, fondacioneve, OJF-ve dhe banorve të rajonit, që përveç mbështetjes morale të ndihmojnë dhe materialisht.

Laura Furxhi

Promovim libri

Arsimore Z. Andrea Mano, etj.

-Mbi vlerat e librit folën poeti Ylber Merdani-pedagogia Jonela Spaho-poetët Edmond Zaçe dhe Fejzi Zenellaku-fabulisti Ali Bregumësuesja e letërsisë Bukurie Hyska, e të tjerë.

-Gjithashtu përshëndetën poeten e re deputetja Ledina Aliholli dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale Arsimore Z.Andrea Mano.

-Aktori Ligoraq Riza recitoi bukur e plot pasion poezi dhe ese nga libri i poetes Mevisa Isallari.

Ylber Merdani
Kryetar i Klubit të Shkrimtarëve
"Bota e re"
Korçë




-Në një nga sallat e Biblotekës "Thimi Mitko" Korçë u bë promovimi i librit me poezi dhe "ese" "Një engjëll erdhi në shtëpinë time" të poetes së re Mevisa Isallari.

-Në promovim merrnin pjesë shoqe të poetes, poetë e shkrimtarë e dashamirës të tjerë të librit. Mernin pjesë gjithashtu: Deputetja Znj. Ledina Aliholli -Drejtori i Drejtorisë Rajonale

DËBORA E PARË NË KORÇË

Poezi-



-Ç'më paska marë

malli,
të loz sot

me topa
dëbore,

si dikur,
kur isha

fëmijë...

-Të los me dëborën
e bardhë,

të pambuktë,
të ftohtë.

e t'a shkrij atë
si dikur,

me afsh
djalërie...

-Ç'më paska marë

malli,

të rëshqas kolovajze,
sot në akullin

e kristaltë,
të rrugicave

të Korçës,
si dikur

me shokë e shoqe
të zënë,

dorë për dore,

e me plot ëndra
fëmijërie...

-Ç'më paska marë

malli,
të shkund sot

pishën
e lartë

të thinjur
nga dëbora,

si dikur kur rinim

poshtë saj,
e bënim dashuri

për të na thinjur
dhe ne,

e për të gjelbëruar
përsëri ajo,

sikur të kish
ardhur pranvera...

Nuk më ***
tremb

moj erë
e marrë,

as ti dëborë
e ftohtë.

Unë kam përbrenda
një prush

të zjarrtë,
të pashuar.

Unë jam stoik,
e përcjell mesazhe

shprese të ngrohtë,

prandaj jam,
si shkëmb

i fortë.
-Si se kuptuat,

njëherë,
Korçën...

Se poshtë dëborës,
është një shtresë

e begatë,
Një TABAN

MIJRAVJEÇAR,
Se dëbora shkrihet,

ikën
e vjen.

Por, po të
mbështetësh

tek ai taban,
Ante bëhesh,

ai s'të gënjen.

VEHBI FURXHI
Korçë, 3 janar 2010

REALIZIMI I NJË ËNDRE DHE INTEGRIMI NË JETËN GJERMANE



Mevisa Isollari

Nga: MEVISA ISALLARI-studente në Berlin të Gjermanisë

sepse për herë të parë do të udhëtoja me avion, për herë të parë do të fluturoja mbi re ashtu si zogjtë, do të shikoja pamje të vendeve nga lart, do të përjetoja një emocion të pamenduar dhe kështu ndodhi, por fatmirësisht nuk ndjeva me frikë, por vetëm emocion. Arrita në Berlin, në një nga kryeqytetet më të zhvilluara të Europës, në një vend pjesë e të cilit jam unë tani. Jetoj në një familje gjermane. Thonë që janë njerëz të ftohtë gjermanet, por unë kam përjetuar momente shumë të ngrohta familjare atje. Fillimi është një stad shumë i vështirë për çdo proces dhe çdo aspekt në jetë. Në fillim, larg

familjes, larg çdo gjëje time përjetova momente plot mister dhe lot. Kur them ngushtë. Mendova se do mister nënkuptoj një hapësirë të panjohur, një botë të re, të paprekur. Ndjeja mall, më digjnin ndjenjat, arrita deri atje sa kërkoja rikthim sa më parë, numëroja ditët deri sa u ktheva për festa, por deri sa dita e shumëpritur, data 18 dhjetor erdhi unë iu përshatata realitetit tim, sepse ajo do të ishte jeta ime e re. Akoma po mësoj gjuhën gjermane në Institutin e gjuhës „Eurasia”. Studioj deri në orën 3 në shkollë pastaj bëj një „takim” me qytetin. Fillova t’i shtoj takimet me të dhe tani po miqësohem dhe shpresoj që

Berlin po kuptoj që për mua asnjë nuk është më e rëndësishme se jeta ime, se për mua ska asnjë interes te di çfarë bëjnë, si sillen ose si reagojnë të tjerët. Për aq kohë sa çdo kush më respekton mua, atëherë ska vend për paragjykime. Është normale që dhe këtu të ketë paragjykime, sepse dhe këtu jetojnë qenie të gjalla dhe nuk ka asnjë qenie pa komplekse. Të gjithë e dimë atë shprehje, asnje s’është perfekt”. Shëtitet e mia dhe miqësia me qytetin më ka njohur me vende të mrekullueshme, me pamje madhështore, gradaçela, pamje historike që kanë zgjuar ndjenja çudie dhe habie të

Shpesh themi dua... dua... larta dhe me ngulm doja të ëndërroj... dëshiroj dhe studioja jashtë, të merrja një këto folje janë pjesë të kulturë të re, dhe këtë rrugë pashmangshme të ligjëratave që pushtojnë fantazinë e fëmijëve, adoleshentëve dhe madje të të rriturve. Tani jam 19 vjet, studioj në Gjermani, kam në dorë librin tim, jetoj një jetë, që vetëm në Tv e shikoja, prek një botë që vetëm mendimet e mia e njihnin, sepse sytë e mi s’e kishin parë. Që fëmijë kam shprehur plot dëshira të çuditshme, absurde e madje të parrealizueshme në atë kohë. Supozoja e thoja ç’më pengon?... Turiste në kozmos pse të mos bredh? Kopsht zoologjik

atje të ngre, Nga hapësirat miqtë t’i përshëndes, Në tavolina të largëta mysafirë të pres... Pastaj filloja me endërimet e mia, me dëshirat e mia të frymëzuara, e si çdo fëmije thoj:- Dua të bëhem flutur, të bredh botën, Dua të bëhem zanë, fustanet ti lodh, Dua të bëhem diell, lulet ti çel, Dua të bëhem yll, hënën të shtyj me bërryll.

Po, a është vallë e mundur që unë të bëhem flutur, yll, diell ose, zanë? Përgjigjia është Jo! Këto ndodhin vetëm në përalla, kurse unë tani jetoj në një realitet. Asnjëherë s’ju kam vënë kufi dëshirave të mia dhe prindërit e mi kanë qënë shtysa më e madhe dhe shkëndija e çdo dëshire time. Mbarova gjimnazin „Preka” me rezultate të

studioja jashtë, të merrja një kulturë të re, dhe këtë rrugë nisa. Mes dy zjarreve zgjedha atë me të nxehtin. Preferova të nis vetë procedurën e largimit nga familja, nga qyteti, nga shoqëria dhe nga vendi im të shumta me doli viza. Ishte data 23 shtator 2009, ra telefoni e mora dhuratën e ditëlindjes, sepse kjo datë është dhe dita ime e lindjes, e mora vizën. Një ditë, dy gëzime. Se di a është e vërtetë po fati ka qënë gjithmonë miku im më besnik që në grimcat e para të çdo ëndërrimi tim. Festova ditëlindjen, por me lot në sy, lot të ndërthurur me gëzim dhe hidhërim së bashku. Gëzim që ëndrra mu bë reailtet dhe hidhërim sepse momenti i largimit po afrohej me hapa hijerëndë. Më dukej shumë larg në fillim largimi, por ja që ai sa vinte e çdo çast, çdo moment, çdo minutë e çdo sekondë po afrohej akoma më shumë. Derisa më në fund erdhi, ishte data 28 shtator kur u largova. Përqafova miqtë e mi, përjetova ndjenja, putha fort familjen time, pashë lot në sytë e njerëzve të mi më të dashur dhe u largova për në Greqi ku më prisnin të afërmit e mi. Para se të shkoja për në Gjermani bëra një eskursion të shkurtër nëpër Athinë, njoha vende të reja, takova njerëz të ndryshëm, por që në ditët e para larg familjes ndjeva mall, mall të thellë. Në datën 3 tetor nisesha për në Berlin, kisha ankth, frike dhe emocion së bashku

Berlin



Berlini është kryeqyteti i Gjermanisë me 3.4 milione banorë, është një nga qytetet më të mëdhenj në Europë.

Berlini është një qendër e kulturës, politikës, medias dhe shkencës, është një nga vendet turistike më të vizituara në Europë.

Qyteti dallohet për arkitekturë të larmishme, jetë nate, art, për rrjet transporti publik perfekt dhe për një cilësi të lartë jetese.

Qyteti ka 4 universitete dhe një numër të madh kolegësh teknike dhe profesionale, Universiteti “Humbold” me 35 000 studentë, Universiteti “Freie” me 35 000 studentë, Universiteti “Teschniche” me 30 000 studente dhe universiteti i artit - “Der Künste” me 4 300 studentë.

shkon ndërmend për ekzistencën time, ku duhet të jem vetë e zonja të përballoj çdo vështirësi, çdo të panjohur, duhet ta kuptoj vetë, ku duhet zotësi për të mos rënë pre e kurtheve të „shoqërive të ulëta” të cilat grepin e tyre e kanë gjithmonë gati për peshkim. Jetoj në një shoqëri ku korrektësia është karakteristika më e fortë për të njohur karakterin e dikujt. Themi në Korçë e në Shqipëri, “korrekt si gjerman”, shprehje me vend, si heq as pikën as presjen. Jokorrektësia me një gjerman tregon mosrespektim dhe ndoshta tallje drejt tij. Por zakonet mbillen, kultivohen dhe rriten në gjirin e familjes dhe fatmirësisht unë e kam pasur shumë të pasur këte gjë dhe korrektësia ka qënë gjithmonë pjesë e karakterit tim, kështu që përshtatja ishte e menjëherëshme. Në jetesën time në

miqësia me qytetin asnjëherë s’më ka penguar të studioj. Ky është qëllimi im, studimi dhe ky ka vend të parë në jetën time të re. Duhet t’i kem të gjitha që të fitoj një vend në universitetin e mjekësisë. Kur them një ndoshta ju duket çudi por kjo është renditja e notave nga një në 4 sepse nota 5 nuk është notë kaluese. Dhe ja kështu me kalimin e ditëve familjarizimi me jetën time të re u bë dhe më i madh dhe lotët po pakësoheshin, kjo jo se unë s’po ndjeja mall por sepse tani unë nisa një fazë të re, tani po rritesha dhe ndërjegjësohesha për çdo veprim timin. Tani që po shkruaj nuk jam me ajo Mevisa qaramane që isha mësuar me mamin kudo, që asnjëherë s’isha e zonja të vendosja vetë për jetën time. Tani jam më e rritur dhe më e fortë emocionalisht. Kështu kaluan ditët shumë shpejt, unë u ktheva në Shqipëri, në Korçë me mallin përvëlues me vete dhe ja u riktheva duke gjetur para meje të servirur një surprizë????...jo, një magji, sepse një ëndërr fëmijore, sepse nga ai fëmijë i frymëzuar sot quhem poete, sepse nga ajo nxënësja e thjeshtë e gjimnazit sot jam me studime në Gjermani. Ngrohtësia familjare me shoqëroi në rikthimin tim, përqaftimet e shoqeve më bëne të ndjej që asnjëherë, pavarësisht largësisë ato smë kanë harruar. Ja kështu e hoqa atë dëshirë të madhe për t’u rikthyer e tani që po iki përsëri duhet të jem më e fortë dhe të mos e lejoj mallin të më mbizotëroje!

PËRQAFOHUNI, miliona, shtrihu në një të puthur, o botë!

* * *

Shiller

-”Njih VETVEHTEN! Frojdi na thotë:
-”E njohe, rindërtoje!”

* * *

-”DHIMBJA është njerëzore, por ne nuk jemi njerëz vetëm për të vuajtur.

Jorgos Seferis

* * *

PAQIA në botë është ëndra e vjetër e mbarë botës, e vjetër, por gjithmonë aktuale, ëndra e pleqve dhe fëmijëve, ëndra e filozofëve dhe poetëve të saj të mirë.

Uollt Uitman

* * *

“Unë nuk bëj asnjë dallim midis antikes dhe modernes, midis gjermanëve, anglezëve, francezëve dhe rusëve...”

-Unë e kërkoj dhe e gjej të “MIRËN KUDO që të ndodhet”

Aleksandër Moisiu

* * *

“DEPUTETËT e parë të popullit janë NËNA dhe MËSUESI”.

Hygo

* * *

“DREJTËSIA dhe LUMTURIA nuk mund të arihen në shoqërinë ku sundojnë lakmia e pangopur për fitime, egoizmi, ambicja dhe hipokrizia.”

Shekspir

* * *

Për XHON BELUSHIN:-”Humbëm një artist të madh nga një vend i vogël”

Roland Regan

* * *

-”ARMËT nuk i sjellin njerëzimit më shumë siguri, por e bëjnë më të varfër”.

Vili Brand

* * *

ARISTOTELIT të urtë i thanë një herë:-
”Të kanë sharë kundërshtarët”. Filozofi iu përgjigj:-”Kur nuk jam aty, le të marim një dru e të më rahin”.

* * *

-”Është rrezik të gjuash

Luanin,

Të tmershëm janë dhembët

e tigrin gri,

Po më i tmershëm nga të gjithë

tmerret,

Është njeriu në çmendurinë

e tij.”

* * *

Shiller

THËNIE TË MENÇURA

“MODERACIONI është madhështi shpirtërore”

* * *

Ciceron

“PAQE s’gjej dhe luftë s’kam për të bërë.”

Petrarka

(shek XV-Rilindas italian)

* * *

“Janë grisur të ndenjura prej çeliku, dhe jo këto prej zabllofi.

Populli

* * *

“Nuk futet minareja në thes”

Populli

* * *

“DELIRI I MADHËSHTISË e “vret” talentin dhe e bën qesharak.

Populli

* * *

“MODESTIA e lartëson virtutin.

Populli

* * *

“Ç’mi do ato petulla, kur mi ul ato vetulla”.

Populli

* * *

“Unë do të jem mik i virtutit dhe jo i fatit”

Skëndërbeu

* * *

“Një KOMB atë çmim që i ve vehtes, atë ia venë edhe të tjerët.

Naim Frashëri

* * *

“Kur MBRETI vjedh një vezë, ministrat përlejsh tërë pulat e fshatit”.

Sami Frashëri

* * *

“Nuk ka gabim më të madh, sesa të ngarkosh me punë të mëdha, ato që mezi bëjnë punë të vogla dhe me punë të vogla ata që bëjnë punë të mëdha.”

Sami Frashëri

* * *

“PROFECIA e Shekspirit:-”Qofsh e pastër si akulli dhe e bardhë si dëborë, prapë nuk shëton nga shpifja”.

* * *

“GËTIA thotë për Bajronin:-”Ai fliste hapur për atë që mendonte dhe kjo e futi në konflikt me gjithë botën”

* * *

“PADREJTËSIA e parë të merr për dore, të shpie tek e dyta, e treta...”

* * *

Gëte

“DIAMANTI edhe shkëlqen edhe pret dhe s’ka nevojë ta lavdërojnë servilët.

Populli

* * *

“DASHURISË kur i je pranë, nuk ja lexon bukurinë..”

Populli

* * *

“GAZETARIA është një furrë që i djeg njeriut çdo gjë, talentin e të gjitha me rradhë, e i mbetet vetëm pasioni”

Anri Barbysn

* * *

ESKILI thotë:-”Zeusi e ndëshkoi Prometeun për fajin që kish bërë, duke ju dhënë zjarrin njerëzve dhe njohuritë për zejet e ndryshme, por nuk dënjoj ti kërkojë falje publike.”

* * *

“Gjërat më të shtrenjta në botë janë: Nderi-Dinjteti dhe Atdheu. Ata që për interesa personale sakrifikojnë dashurinë për Atdheun, kanë sakrifikuar nderin dhe dinjtetin.”

Sami Frashëri

* * *

“QEVERITARËT tanë ndahen në tre kategori:- Në qeveritarë të ndershëm e të zotë, që dinë t’i bëjnë vetë punët e qeverisë. Këta janë më të mirët. Në qeveritarë që nuk dinë këto punë, por që tërheqin rreth vehtes njerëz të zotë. Këta janë mesatarë. Dhe në qeveritarë që, as janë të zotë vetë t’i bëjnë punët e qeverisë, as dinë të tërheqin rreth vehtes njerëz të zotë. Këta janë qeveritarët tanë.

Fan S.Noli

* * *

I MENÇURI nuk bëhet

i ashpër skëterë,

por as dele sa

nderi t’i bjerë,

as ngrihet krenar

pa lezet,

as ulet servil

pa kimet.

* * *

Sadiu

I mbledhi: Laura Furxhi

TOPONOMIA E ZONËS SË KORÇËS

Nga studiuesi: NEDAI THËLLIMI

Hyrje
Toponimia është degë e rëndësishme e shkencës të gjuhësisë. Përbëhet prej dy fjalësh toposvend dhe nimo-emër. Studimi i saj ka rëndësi të veçantë për gjuhën, historinë, etnografinë etj, sepse nëpërmjet të dhënave që jep ajo mund të vilen dëshmi me shumë rëndësi për këto degë të diturisë., të cilat është vështirë të mblidhen dhe të sigurohen në një hulli tjetër. Toponomia ka dy degë: makrotoponomia dhe mikrotoponomia.

Me toponominë e Shqipërisë e në veçanti me atë të zonës së Korçës janë marë disa studiuës të huaja vendas. Objektivi i tyre ka qënë studimi direkt ose indirekt i saj. Megjithë punën e kryer deri tani mendojmë se ende mbetet shumë për të kryer. Kjo është arsyeja që na shtyu të ndërmarim këtë nismën me synim për të dhënë ndihmësën tonë modeste në këtë drejtim mbas një pune disa vjeçare plot pengesa dhe vështirësi. Toponimet e zonës së Korçës janë me

prejardhje nga gjuhë të ndryshme shqip (shq), sllavisht (sl), me pak të greqishtjes (gr), turqisht (tur), bile edhe isoglosa, kelto-shqiptare. Me pikëpyetje kemi shënuar toponimet e pamundura të shpjegohen. Në toponiminë e zonës së Korçës, mbizotëron makrotoponomia në gjuhën sllave dhe atë në shqip. Në mikrotoponimi mbizotëron ajo në gjuhën shqipe. Kjo dukuri shpjegohet me faktin se kjo pjesë territoriale e vendit tonë ka qënë për një kohë të gjatë në sundimin e shtetit bullgar.

Nga viti 853 deri në 1018 dhe se administrata bullgare me zotërimin e një territori të porsapushuar hartonte menjëherë regjistrimin e tij dhe çdo komunikim kryhej i detyruar në gjuhë sllave të pushtuesit, kështu që banorët shqiptarë “Me hir dhe me pahir” ndiqnin rregullat e pushtuesit. Mbreti bulgar Borisi, porsa pushtoi këtë zonë krijoi njësinë administrative “Kutimiçevica” (sll) (territore të porsa pushtuara) me qëndër qytetin e Devollit (dikur në

ngushticën e Cangonjit) e cila në regjistrimin e vet administrativ çdo emër që i përkiste makrotoponomisë e ka përkthyer e shënuar në gjuhën sllave megjithëkëtë fakt banorët vendas ka ruajtur emrin shqip vendas për emërtim. Në këtë drejtim shembujt janë të shumtë për shembull: Mborja shënohet Emporian (treg), kurse vendasit vazhdojnë ta emërtojnë shestje (nga shes), Bellovoda (ujë i bardhë) e ka marrë emrin nga burimi mineral me të njëjtin emër sikundër

thuhet edhe sot e gjithë ditën, binomi Guri i Kamjes shqip gur-sllavisht kamen-gur, etj. Në hartimin e këtij punimi kemi shfrytëzuar të dhëna e literaturë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, dokumente historike e arkivore, të dhëna mblidhur për vite me rradhë prej nesh direkt në teren. Mendojmë se me gjithë punën e kryer deri tani në këtë drejtim mbetet ende shumë për të bërë, i takon të ardhmes të marrë përsipër e të thotë fjalën e saj në këtë drejtim

Autori

A
1-Antipatrea-Qytet i vjetër. Identifikohet me majën e Gardishtes në afërsi të qytetit të Maliqit. Emri vjen nga njëri prj gjeneralëve të Aleksandrit të Maqedonisë.

B
1.Babie - Fshat në Komunën e Gorës?
2.Bos- Fshat në Komunën e Gorës. Nga Boc pronë shtetërore ka një fshat Bash në Devoll ku s=sh dhe një tjetër në Kolonjë Boshanj.
3.Boz - (tur) pronë shtetërore. Ka dhe një fshat të vogël në Devoll me emrin Bosh=s=sh
4.Bungë - fshat i braktisur afër Zerecit, komuna Moglicë në kishën e të cilit janë varrosur princat e shtëpisë Muzaka e përmend për herë të parë Gjon Muzaka në Gjenealogjinë e tij në (1510) emër druri pyjor (Pinus Nigra)

Pisha e zezë (shq). dhe Belishtë (kjo e fundit latinisht vend i bukur, i begatë).
5.Beçi - fshat i braktisur në Opar-vend ku kafshët pinë ujë kur janë në kullotë.
6.Brozovec-fshat në komunën Lekas (Opar) Profesori rus Selishçev në veprën e tij “sllavonskopje naselenije e Albanai” (Banorët sllavë në Shqipëri) mendon se rrjedh nga fjala bullgare “brazdë” ku a=o hulli. Ne mendojmë se rrjedh nga fjala sllavisht “rosa”-vesë.
7.Biranj-Komuna Bulgarec?
8.Bigël-Qafë mali në rrugën Korçë-Goricë dhe në atë Korçë-Dardhë. Qafë-shteg mali (shq)
9.Bubuj - Fshat Komuna Pirg?
10.Beras - Fshat Komuna Pirg?
Përbëhet nga 4 lagje që emërtohen: Beras;Pekas;Grismas

dhe Belishtë (kjo e fundit latinisht vend i bukur, i begatë).
11.Bezmisht-Fshat Komuna Liqenas (Pustec). Vendasit e quajnë Tumeneç (sll) -vend me mjegull shumë.
12.Bellovodë-Fshat Komuna Mollas-Ujë i bardhë (sll) Nga Bello i bardhë dhe voda-ujë.
13.Bickë-Fshat në Komunën Progër dhe Kullotë verore (shq)
14.Bulgarec-Fshat në Komunën homonime-vend i banuar prej bullgarëve (sll)
15.Belorta-Komuna Pojan-i begatë (lat) ose i bardhë (sll)
16.Barç - Komuna Bulgarec. Nga apelativi shqip “barçë”, kopësht nga turqishtja po me atë kuptim. Ka një fshat Barç edhe në rrethin e Skraparit.
17.Bravdicë-fshat Komuna Miras-(Druvar Bravda) (sll)-sopatë

18.Bozovec-Pyll me emër njeriu ose titull ushtarak (kapter) dhe-lindje të Korçës Kolivend, tokë, pronë.
19.Buçovë-Toponim fshat me emrin Qete në Opar afër Zerecit sot i braktisur ku ce=ç.
20.Buvava-ku a=o (sll) zhurme erë.

C
1.Cangonj-Sipas Th.Mitkos rrjedh nga greqishtja-Angonbërryl rruge. Sipas fjalorit të gjuhës arbërisht (Itali) të E. Xhordonos nga fjala shqipe Cangë-Balse ose e re ka pasur një fshat me këtë emër edhe në Çamëri.
2.Çershenik-Fshat Komuna Pirc-Çeresha (sll) Qersh
3.Cerje - Fshat Komuna Lekas dhe Liqenas, (Xerje)-Panjë-dru pyjor
4.Çaushlli-Fshat Komuna Pirc. Nga dy fjalë turqisht:Çaush-

emër njeriu ose titull ushtarak (kapter) dhe-lindje të Korçës Kolivend, tokë, pronë.
5.Çeta-Fshat Komuna Selishçev Mendon se rrjedh nga boz-shtok Çetinë Pisha (shq) ka qënë dikur edhe një fshat me emrin Qete në Opar afër Zerecit sot i braktisur ku ce=ç.
6.Çir-Dikur fshat Komuna Mollas, sot i braktisur midis Bellovodës dhe Kamenicës i pa identifikuar?
7.Çiflig-Fshat Komuna Bulgarec. Pronë bujqësore nga turqishtja; çift-dyshe sipërfaqe njësi matjeje që mund të punohet me një çift (pendë qe)
8.Çemericë-Fshat Komuna Vithkuq. Emër bime në gjuhën sllave (Çemerik) bimë helumese për kafshët e imta shqip shtjar (veratrim alba). Me helmin e saj është vetëhelmuar filozofi i njohur i Greqisë të lashtë Sokrati.

D
1.Damjanec-Fshat Komuna Voskop. Nga Damjaneci (sll) emër njeriu.
2.Dobërcan-Fshat Komuna Moglicë. Debër-ku o=ë, nga sllavishtja e kishtarë = Grykë kanion malor. Nga kjo fjalë rrjedh dhe emri i qytetit shqiptar Dibër në Maqedoni.
3.Dobranj-Fshat, Devoll, Grykë mali-Derb (sll) ku o=ë
4.Dekaxhatçe-Fshat i braktisur në zonën e Korçës. Tefteri i Korçës dhe fermentit (vitet 1431-32 fq.75)?
5.Derven-Grykë mali (tur). Ky toponim haset shpesh në trojet shqiptare.

Vazhdon në numrin e ardhshëm

-Ishte ora 21^{oo} e mbrëmjes dhe unë shtrirë në divan po lexoja romanin "Dëgjo floriri im"- të shkrimtarit korçar, emigrant në Kanada Kristaq Turtulli, kur papritmas ra zilja e telefonit dhe nëpërjet receptorit mora lajmin, se një miku im, ishte shtruar urgjentisht në spitalin "Amalia Flaming" në Athinë. U shqetësova për shëndetin e mikut tim dhe nëpërmjet celularit fillova të interesohem për të siguruar mjet udhëtimi. -Nuk thonë më kot: "Fqinji është më i gjenduri, se kushdo tjetër". Kështu bëra dhe unë. I telefonova Piro Çipit, që është komshiu im, i cili u tregua i gatshëm për të udhëtuar ditën e nesërme.

-Dhe kështu filloi udhëtimi për në Athinë në Kryeqytetin e Greqisë. -Ishte një ditë e ftohtë dhjetori 2009, por ne nuk e ndjenim në veturën e ngrohtë "Benx". Bashkë në makinë me ne udhëtonin dhe një grua bashkë me dy vajzat e saj. Mbas kaluam qetësisht doganën tonë të Kapshticës dhe ata të shtetit fqinjë Greqisë, filluam të bisedonim. I pari e hapi bisedën shofer Piroja. -Që të njihemi, mu drejtua mua, kjo zonja është e shoqja e Pandeliut, një mikut tim, quhet Valentina dhe këto janë çupat e saj Kristina dhe tjetra Johana-emigrante të Greqisë. Dhe mbas prezantimit tim, filloi ashhtu thjesht e çiltër biseda, duke më treguar nga ai vendi ku ato jetonin e punonin. -Përveç ishullit Kos është dhe Prenda, ishull turistik, me hotele të shumta e të bukura, ku vinë turistë nga Anglia-Gjermania-Italia-Franca, etj. Unë me burin punojmë në një hotel turistik thotë Valentina. Ishulli Hipokrati (ka marrë emrin e babait të mjekësisë) ka 50 mijë

banorë, ka shumë shqiptarë emigrantë. Karakteristikë janë fshatrat turistike si Karshkrimtarit korçar, dhamenu-Qefalo, etj. -Po pse vinë kaq shumë turistë nga bota?-pyes unë. -Valentina sqaroi: ka bregdet të bukur, rërë të grimcuar imtë ngjyrë floriri, ujë të pastër, hotele komode, restorante me kuzhina karakteristike-disko-buzuqenëpërmjet celularit fillova këngëtarë, si këngëtari i njohur Notis Sfagranakis, i cili të magjeps me zërin e tij melodioz e këngët e tij të bukura që këndon. Bëhet jetë nate... -Greqia, shton Piroja në bisedë nxjerr të ardhura të mëdha nga turizmi, ne tani po e kuptojmë këtë lloj biznesi me leverdi të madhe. -Në bisedë hynë dhe të dy vajzat Kristina, e cila është në vitin e dytë për "Sallon bukurie", e cila mbas një viti mbaron shkollën dhe do të çelë një "Sallon bukurie" moderne, sepse turistët nga e gjithë bota, duan dhe shërbimet sipas shijeve estetike nga vendet që vinë. -Johana tregon se, është në gjimnaz dhe ka dëshirë të vazhdojë për fizioterapi. -Të dyja qeshin kur thonë, se do martohen me djem shqiptarë dhe se një ditë do të kthehen në vendlindje, shpresojmë që të na ecë fati për mirë, kudo që të jemi, sepse "Fati i femrës nuk dihet", me gjithëse, disa mbrojnë tezën: "-Fatin si ta bësh!..." -Udhëtonim në autostradë. Piroja, diç bluante në kokë dhe rinte i heshtur duke meditaruar... -Çke Piro që u bëre kaq i heshtur?-(si për ta zgjuar nga topitja), i them unë. -Piroja qesh, e përgjigjet. Po bëja një llogari të thjeshtë me mendje. Kam që në vitin 1991 që punoj me taxi-rrugët e Greqisë, më del sipas llogarisë të kemi bërë 2 milion km,

SHPRESA

(Shënime udhëtimi Korçë-Athinë-Korçë)

Nga: **VEHBI FURXHI**

Athina



ndërsa njerëzit që kam duket e çuditshme, por shpënë në Greqi dhe që mbrëmë kam fjetur me kam sjellë nuk i llogaris nënën, si dikur kur isha e dot.... -Emigracioni për vitet e para të demokracisë ka qënë i nnevojshëm, sepse nuk kish punë... -Në emigracion gjetën punë, mësuan gjuhën greke, fëmijët i futën nëpër shkollë, përmirë-



suan nuvelin e jetesës dhe u njohën me kulturën dhe traditat e vendasve, duke pasqyruar dhe tek ata, kulturën e traditat tona, krijuam miqësira. Në Selanik thotë Valentina kam motrën që herë pas here vetë e shoh. Në Korçë kam vëllanë Petro Zhidro-ka një (Punishte për përpunimin e qumshtit në Maliq) dhe mamanë e babanë. Malli më mer shumë dhe çdo vit vi e çmallen me ta. Do t'ju

shkruhej: "Psistaria" që do të thotë "mish i pjekur në skarë me qymyr". -Në horizont ngriheshin madhështore malet e hirtë "Meteor", me manastiret e famshme dhe me legjendat e formimit të këtyre maleve që rrallë i gjen në ndonjë vend tjetër. Bëmë disa foto dhe mbas drekës së shijshme vazhduam udhëtimin përsëri. -Në Afërsi të Athinës (Kastro), por dhe më përpara (Lamia) në maja malesh dhe grykash ku korentët ajrore janë të fuqishme, Piroja më tregoi për elikat treshe me gjeneratorë që nën veprimin e erës prodhojnë energji elektrike. Këto thotë Piroja, mund të aplikohen, edhe në "Grykën e Cangonjit"... -Greqia i shfrytëzon të trija "burimet" e prodhimit të energjisë elektrike me Hidrocentrale, termocentrale (me qymyrguri) dhe ato me anë të erës. -Mbrëmja kish rënë me tisin e tij të herët, në kryeqytetin grek Athinë, por reklamacionet me drita të shumta për festat e Krishlindjes dhe Vitin e Ri 2010, llaburisnin shumëngjyrësh dhe më një bukuri mahnitëse. -Unë qëndrova tek spitali i përgjithshëm shtetror "Amalia Flaming" (Ky spital para shumë vitesh është ndërtuar, si dhuratë nga Amalia e shoqja e shkencëtarit të famshëm Flaming, i cili zbuloi Penicilinën) për të vizituar mikun tim në repartin e kardiologjisë, ndërsa Piroja bashkë me Valentinën dhe dy çupat udhëtuan për në pjesën tjetër të Athinës, duke lënë për të nesërmen orën e kthimit për në Korçë. * * *

Athinë-Korçë

-Në mëngjezin e ditës së nesërme-Piroja erdhi në orën 9^{oo}, bashkë me 3 pasagjerë që i kish marë në Pire. Gjatë natës kish rënë shi dhe autostrada dukej e bukur dhe e pastër si pas dushit të natës.

-Pyetja e parë që më bëri Piroja i shqetësuar ishte: -Ë, si ishte me shëndet miku yt?!.... -Falë kujdesit të mjekëve të atij spitali dhe personelit shëndetsor dhe aparaturave bashkëkohore-"ja kish hedhur", dhe së shpejti do të dalë nga spitali, për të pushuar pranë familjes së tij në një qytet bregdetar të bukur, jo më shumë se 50 km nga Athina. -Ai është emigrant, prej shumë vite, ka blerë shtëpi, të 2 djemtë dhe gruan, ka në punë, vajzën në Universitet. Është mme "Ika" (i siguruar) dhe spitalin dhe ilaçet i ka falas. -Po këta zotërinjtë nga i kemi e pyes unë Pirron, sa për të ndezur muhabetin. Dhe kështu duke udhëtuar për në Korçë e duke biseduar me tre emigrantët shqiptarë, unë po jap disa grimca nga jeta dhe puna e tyre në Greqi:- -Artan Mankolli-(nga Golloberda e Korçës) -Kam ardhur në vitin 1995 në Greqi dhe jam vendosur në ishullin Rodos. U vendosa këtu, sepse në ishujt turistikë bëhen ndërtime, ka punë. Kam punuar gjatë këtyre viteve, në ndërtimin e vilave 2-3 katëshe. -Rodosi mund të ketë 30-40 fshatra turistikë, unë në fillim jetoja e punoja në fshatin turistik Paliraqis, vend shumë i bukur turistik, 5 km nga kryeqyteti i ishullit Rodos, që mban të njëjtin emër, tani jam në fshatin Jonadhi-Ai ka 500 shtëpi. Ka motele, por dhe hotele me 5 yje e me shumë kate (11-12 kate), me restorante, bare moderne, disko, etj. Ka kodra të buta, ku kultivohen ullinjtë -mandarinat-rrushi... (Vijon në faqen 7)

-Edhe në Palaraqis dhe në Jonadhi, por dhe në të tjerë vinë turistë nga: Gjermania-Islanda-Hollanda-Anglia-Polonia-Italia... Nuk bën dimër, s'bie dëborë, turistët gjermanë lahen edhe në dhjetor. Vendasit ritin një lloj dhije endemike për qumësht e mish.

-Karakteristike është pjekja e kecit, ka mish shumë të shijshëm dhe turistët e pëlqejnë shumë, por ka dhe lloje peshqish si: Lavraqi-Cipari (i vogël i kuq) Forfur peshk i madh deri në 5 kg (për fileto) etj.

-A ke dëgjuar për "Gjigandin e Rodit"-thotë

Artani-ku nën këmbët e tij kalonin vapore e anije e rëzoi tërmeti, a vullkani dhe pastaj vazhdon: Ka mjaft shqiptarë që punojnë në fshatrat e Rodosit dhe nga Korça, por dhe nga Fieri, Vlora, Berati, Kuksi, etj.

-Ne punojmë e sillemi mirë me grekët, na duan e na respektojnë. Jemi me "karta" të rregullta të siguruar e kemi mjaft lehtësira, por kriza si kudo në botë, ndjehet edhe në Greqi, por

e EMIGRANTËVE

futbollisti Altin Haxhi ka luajtur në skuadrën e futbollit të Kretës. Klima e Erakleos është si e



shpresojmë të kalojë pa shumë "dhimbje" dhe shpejt.

-Disa vlonjatë kanë blerë Iraklio. Në fillim kam shtëpi dhe janë vendosur për gjithnjë, unë do të kthehem një ditë në Korçë...

Arben Mahmutllari: "Dixhital" (Aparat që (O s h t e c - K o m u n a

Trebinjë-krahina e Mokrës -Pogradecit) -Unë jetoj në Rethimio- qytet me 40.000 banorë në ishullin e Kretës.

-Kam 4 vjet emigrant, jam i martuar me dy fëmijë (djali 14 vjeç-çupa 10 vjeç).

-Kam punuar në ndërtim, por tani "ka rënë puna", prandaj jam shpërngulur në Kostur. Shpresoj të jem më mirë këtu, jam dhe më afër Shqipërisë-Mokrës time të dashur.

-Në këtë qytet antiko-turistik ka kala të larta me bedena që shtrihen deri në 5-6 ha, sipërfaqe 60-70 metro të larta, me tylene, mure të trashë, të ndërtuar me një gur të bardhë me rërë deti e gëlqere, në toka, orendi shtëpiake të kohës, etj.

-Ka 4 xhami (që në kohën e Pushtimit turk) shumë kisha të vjetra, manastire e murgësia, vizitohen nga turistët.

-Emigrantët ju mësojnë gjuhën amtare shqip fëmijeve në shtëpi.

Xhevit Çerri:(nga fshati Bërzeshtë i Librazhdit)

-Kam 9 vjet emigrant në ishullin e Kretës dhe 10 në Kryeqytetin e saj Iraklio. Në fillim kam punuar në ndërtim, ndërsa tani kam një dyqan me vëllanë Kastriotin, që tregëtojmë aparate nga sateliti).

-Në Iraklio ka tre universitete, në njërin prej tyre ka fakultet mjekësie, ku janë diplomuar dhe mjekë nga Shqipëria dhe nga Korça, gjithashtu ka dy spitale shtetërore, (Venizello-Papakli), bashkëkohore, me mjekë e specialistë të shkolluar në perëndim.

-Në universitete studiojnë bashkë me grekë dhe fëmijët e emigrantëve shqiptarë që jetojnë e punojnë në Kretë dhe kanë rezultate të larta në mësim.

-Jam i martuar dhe kam dy fëmijë, 1 herë në katër muaj vij në shtëpi pranë familjes në Bërzeshtë-vazhdon të tregojë Xhevit. Emigrantët duhet të respektojnë ligjet e shtetit grek, siç duhet të respektojnë ligjet e shtetit shqiptar. Unë i kam të gjitha dokumentacionet e rregullta dhe siguracionet "Ika", kur jam ndonjëherë i sëmurë ilaçet i marr me rimbursim nga shteti grek p.sh në qoftë se ilaçet bëjnë një shumë të

KRETA është ishulli më i lashtë i Greqisë dhe ishulli i pestë për nga madhësia i Detit Mesdhe. Me një sipërfaqe prej 8.336 km². Është një nga 13 periferitë e Greqisë. Ka një rol të rëndësishëm në trashëgiminë kulturore dhe ekonomike të Greqisë ndërkohë që ka ruajtur vecoritë e saj kulturore si dialektin e saj dhe muzikën. Heraklion është qyteti më i madh dhe kryeqyteti i Kretës. Kreta është qendra e civilizimit Minoan, civilizimi më i vjetër i Greqisë. Ishulli është vendodhja e qendrave të vecanta historike antike dhe kjo e bën atë sot tepër të pupulluar nga turistë të huaj. Kreta ka patur një popullsi prej 650.000 banorë në vitin 2005 dhe përbën kështu një nga 13 rajonet më të mëdha në Greqi dhe të dytin pas Qipros në Mesdheun Lindor. Ishulli ka një gjatësi prej 260 km dhe gjerësi prej 60 km, megjithëse është i ngushtuar në pika të vecanta Kreta është komplet malore dhe ka shumë male gjatë vijës nga perëndimi në lindje e formuar nga tre grupe të ndryshëm malesh.

Për shekuj me radhë Kreta ka mbajtur të pacënuar pasurinë e saj natyrore të vecantë dhe kulturën e saj. Greqishtja e Kretës është mbajtur si dialekti i folur dhe vera e prodhuar në Kretë është një pije tradicionale. Ishulli i Kretës është i njohur për muzikën e tij dhe ka shumë kërcime vendase, më e njohura nga të cilat është Pentozali.

Kreta është një nga ishujt më të populluar në kohën e pushimeve verore në Greqi. Heraklion është port dhe aeroport, ndërsa udhëtimet "Çarter" për në Heraklion vitet e fundit përbejnë 20 % të të gjitha udhëtimeve në Greqi. Rreth më shumë se 2 milion turistë e vizituan Kretën vitin e kaluar. Sot, infrastruktura e turizmit të këtij ishulli plotëson të gjitha shijet duke përfshirë një shumëllojshmëri akomodimi. Luksi i këtij ishulli duket tek hotelet luksozë, pishinat, sporti dhe argëtimi, apartamentet, etj. Vizitorë nga e gjithë bota mund të arrijnë në këtë ishull nëpërmjet dy aeroporteve ndërkombëtarë të Heraklion dhe Chania, ose me varka nëpërmjet porteve kryesore të Heraklion, Rethimno dhe Agios Nikolaos.



Rodos

Ishulli i RODOS ndodhet në gjatësi gjeografike 28° nga Greenwich dhe në veri me një gjerësi 36°, në pjesën jug perëndimore të Detit Aegean. Sipërfaqja është 1398 Km. me një gjatësi maksimale prej 77 km dhe një gjerësi maksimale prej 37 km, është ishulli më i madh i kompleksit Dodecanesse. Ka toka të përshtatshme për ritjen e perimeve dhe frutave. Fillimisht është populluar në periudhën prehistorike, por me kalimin e kohës ishulli u bë një nga pikat kryesore tregtare me detin Mesdhe. Në ditët e sotme Ishulli Rodos është një amalgam mesjetar dhe modern, i cili befason dhe surprizon vizitorët e huaj me muret e saj të forte e mahnitës, me hotelet luksozë, me bulevardet plot pemë anash rrugëve, me ndërtesa të bukura e dyqane moderne. Është një ishull ku epoka e mesjetës dhe moderne janë ndërthurur shumë bukur. Rodos është në fakt ishulli i diellit, detit dhe rërës, por edhe kur nuk ka diell ai ka plot për ti ofruar vizitorëve, sepse Rodos është ishulli i kulturës dhe civilizimit. Pozicioni i tij gjeografik në Detin Mesdhe e ka bërë atë të preferuar për një kohë të gjatë në histori. Ishulli i Rodos ndodhet në kryqëzimin e dy rrugëve të mëdha detare të Mesdheut midis Detit Aegean dhe gjirit të Meslindjes, si dhe midis Qipros dhe Egjiptit. Për një kohë të gjatë historike popuj të ndryshëm që kanë jetuar në ishulli Rodos kanë lënë gjurmë në kulturën e këtij ishulli si në art, gjuhë dhe arqitekturë. Pozicioni i tij strategjik solli në këtë ishull shumë pasuri dhe e bëri qytetin e Rodos një nga qytetet kryesore të botës antike Greke. Rodos është ishulli më i madh në Dodecanese. Kryeqyteti i tij, që ndodhet në pjesën veriore të ishullit është kryeqyteti i Prefekturës me qytetin mesjetar në qendër të tij. Në 1988 Qyteti Mesjetar u emërtua si një Qytet me Trashëgimi Botërore si rezultat i arqitekturave të ndryshëm që i përkisnin periudhave të ndryshme historike, kryesisht periudhës së kalorsëve të St.John. Muzeumi Arkeologjik i Rodos është vendosur në një ndërtesë të mesjetës i quajtur "Spitali i Kalorsëve". Muzeumi është një ndërtesë dy katëshe me një kopësht brenda, katër pjesët e të cilit janë të lidhura së bashku në një portik. Në 6 dhomat e tij dhe në kopësht janë gjetur objekte të ndryshme që datojnë nga periudha të ndryshme historike të këtij ishulli, si ajo klasike, kristiane, kalorsiake, otomane, italiane dhe të ditëve të sotme. Objektet që janë zbuluar gjatë gërmimeve arkeologjike mund të jenë varre, skulptura, figura, vazo, bizhuteri, objekte metalike, pllakë vari, etj. të periudhave të ndryshme.

caktuar euro, 70 % i Durrësit, bie pak dëbo-sunvencionon shteti.

Megjithatë edhe ne emigrantët shpresojmë për më mirë, qeveria e re ka bërë premtime gjatë fushatës zgjedhore, duhet tani të mbajë premtimet.

-Në Irakleo, ka shumë muze, dy kinema, dy teatro, etj. Këngëtaja Ana Visi që fitoi çmimin e parë në "Euro Vizion" është nga Kreta.

Gjithashtu ka dy stadione të mëdhenj, skuadra kryesore e futbollit "Ogotelis"-portier i kom-bëtares tonë, si dhe

rrë, por nuk mban, në male dëborë vete deri në 2 m. Nuk e di dhe sa do të ri në emigracion, por një ditë do të kthehem.

-Arbenin e lamë në Kostur, Artanin në Gollobërdë, ndërsa Xhevitin e shpëmë tek stacioni i fugonave në Korçë dhe e përcollëm për në Librazhd, duke iu uruar:- Unë e Piroja!

"Gëzuar festat, shëndet e lumturi! Mirupafshim! * * *

-Hyra në një sallë, që gumëzhinte nga njerëzit, që përskuqej nga ngjyra

Shqiponja e stuhive

Veprimtari që përcolli paqe, krenari, dashuri.

-Fotografitë dhe duartrokitjet ishin vlerësimi më i mirë për punën e vazhdu-



salla të kumbonte. Të figura të shquara të gjithë: të vegjel e të historisë e përpjekjeve mëdhenj, këndonin fuqi për çlirimin e Shqipërisë, shëm. Emocioni përshkaku me moton

llëzohej nga vargu në varg “Le të ngrejme lart dhe ndjenja e krenarisë të flamurin, mbushte gjoksin. ashtu si Skënderbeu vetë,

-Në fjalën e saj, drejtoresha e shkollës, zonja e të ngelet i paharruar,

Dhialekti Kantidhu, pasi -Këngët patriotike mbushnin sallën dhe shoqëroshmit, theksoi “Historinë nuk e bëjnë datat, por nga të pranishmit. Niveli i

zjarri i zemrave” dhe me interpretimit të tyre tej: “Një popull, që nuk di tregonte se ishin përga-

historinë e vendit të vet, titur nga specialistet e është i destinuar të muzikës dhe nga më-

zhduket. “. Më pas, vijoi sueset e apasionuara aktiviteti me deklamime Marianthi Vrame dhe poezish të ndryshme, Katerina Bamiha.

-Pjesa teatrore, me kushtuar atdheut, festave, luftës për liri e pavarësi, u veshjet e zgjedhura dhe ngritën lart e u nderuan aktrimin e pasionuar, të



e një flamuri të stërmadh, që zinte gjithë podiumin. Gjithçka ishte e ndezur si për festë.

-Isha ftuar të merrja pjesë në një program me rastin e Festave të 28-29 nëntorit, organizuar nga klasat e treta të kolegjit të Korçës “Omios”. Së

bashku me nxënësit e kolegjit, kishin ardhur të gëzonin mjaft prindër e të ftuar.

-Veprimtaria u çel me ekzekutimin e himneve, kënduar nga kori i nxënësve të tri klasave, por Himni Kombëtar të Shqiptar bëri që e gjithë

mbushnin me krenari e dashuri për vendin dhe admirim për këta aktorë- nxënës, që të bënin për

vetë me çiltërsinë dhe aftësinë për të përcjellë harmoni, patriotizëm,

vlerësim të gjithçkaje të së shkuarës në funksion të gëzimit të së tashmes.


eshme, që bën kjo dashuri për vendin dhe admirim për këta aktorë- nxënës, që të bënin për

vetë me çiltërsinë dhe aftësinë për të përcjellë harmoni, patriotizëm,

vlerësim të gjithçkaje të së shkuarës në funksion të gëzimit të së tashmes.

Liljana Jahollari

Paraqitet libri poetik :-“Korçës një fjalë dashurie”



PERËNDESHAT

Ka vajza të bukura ky qytet.

Jo si kudo.

(Të shëmtuarat vdiqën-po ju them!)

Kur Korçës i ikin dritat, janë ato,

Që ndizen e ndriçojnë nëpër terr!

Ka vajza prej ajri ky qytet.

Jo si kudo.

(Ndaj me ajër kurrë nuk ngopemi!)

Kur Korçë bie borë, janë ato,

Zjarre, ku zgjatim duart e ngrohemi!

Ka vajza prej puthje ky qytet.

Jo si kudo.

Prandaj i ka të artë dhe muzgjet!

Botën, ne e dimë që Zoti e krijoi,

Po Korça ka lindur nga puthjet!

”Rotary”-Korçë

dhe Bibliotekën “Thimi

Mitko”, organizuar në një

nga sallat e saj Paraqitjen

e librit poetik të Skënder

Rusit për Korçën

“Korçës, një fjalë

dashurie”.

-Merrnin pjesë poetë,

shkrimtarë, artistë dhe

dashamirës të poezisë.

-Merrnin pjesë gjithashtu

Kryetari i Bashkisë Korçë

Z.Niko Peleshi-Krye-

tari i Këshillit Bashkiak

Z.Gjergji Pendavinji-

të librit. Në vazhdim e

President i “Rotary”-

Korçë Z.Servet Feka,

Koçiu-Edmond Zaçe-

-Moderatoria e aktivitetit

Znj. Benila Tërova,

përsëritet të pranishmit

dhe tregoi qëllimin e

organizimit të aktivitetit si

dhe për jetën dhe krijim-

veçanti mbi librin

Skënder Rusi. Më pas

dashurie, duke theksuar

ajso bashkë me aktoren

Zamira Kita dhe

Ligoraq Riza inter-

pretuan poezi të spikatura

jeton, cilësinë e lartë e

morrën fjalën Z.Hamza

duke zënë kështu një

vend nderi midis poetëve

Dhimitër Bello-Klito

Fundo-At.Spiro Katundi-

-Në fund e mori fjalën dhe

poeti Z.Skënder Rusi, i

të cilët folën mbi cili

falenderoi të pranishmit

dhe në fjalët e ngrohita dhe

por në veçanti dhe për

dashurie, duke theksuar

librin e ri: “Korçës një

fjalë dashurie”.

-Për të pranishmit u dha

një “Koktej”.

Laura Furxhi



FIGURA QË I BËJNË NDER HISTORISË SKËNDER PETRO LUARASI (1900-1982)

(Me rastin e 110 vjetorit të lindjes)

-Në 19 janar të këtij luftëtarin e vendosur viti mbushën 110 vjet antifashist, lëvruerin e nga dita e lindjes së pasionuar të gjuhës patriotit e demokratit të shqipe e shprehjes poetike shqiptare, publicistin e zot, mësuesin shquar erudit, profesor dhe pedagogun e talentuar, shkrimtarin e Skënder Luarasi. -Jeta e Skënder Luarasi, sipas vlerësimeve të bëra, i ngjason një vullkani në aktivitet të vazhdueshëm, të cilit, sinqeriteti dhe guximi qytetar e krijues, i sollën shumë probleme dhe tronditje të mëdha, por që nuk u tërhoq asnjëherë nga udha e jetës, me kredon e tij të formuluar që në rininë e herëshme: "Për një Shqipëri krejt të lirë e demokratike, një popull shqiptar të kulturuar e të lumtur". I rritur me idealet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare e asaj Evropiane, Skënder Luarasi radhitet, pa asnjë mëdyshje, në ballin e elitës intelektuale shqiptare, që gjatë gjithë jetës së tij, si shqiptar i vërtetë, iu përkushtua çështjes kombëtare, duke qëndruar kurdoherë i vendosur e konsekuent në luftën për liri, demokraci e prosperitet të gjithëanshëm të kombit. -Figura e Profesor Skënder Luarasi, është tepër komplekse. Tek ajo gjen të skicuar qartë: atdhetarin dhe demokracin e madh, deri dhe me vetë udhë-

heqësin, e pa u trembur e tronditur, duroi të gjitha mallkimet e Zeusit në "Veprat" e tij, Petro Nini Luarasi aforizmat e mallkimet, duke u shndëruar në simbol të luftëtarit model të fjalës së lirë e me kulturë demokratike, gjatë gjithë jetës, tehu i mprehtë i fjalës së tij të zjarrtë, mbeti ashtu i zhveshur dhe qëlloi ballazi, pa kërkuar aleatë e bashkëpunëtorë. -Skënder Luarasi ka lindur në fshatin Luarasë të rrethit të Kolonjës. 110 vjet më parë, më 19 janar të vitit 1900 në një famije me tradita atdhetare e arsime dashëse, mësimit e para në shqip i mori nga i ati i tij, martiri i shkollës shqipe; Petro Nini Luarasi. Më pas vazhdon studimet me bursë në Stamboll në "Robert Kolezh" së bashku me shumë bashkëmoshatarë të tjerë shqiptarë. Mbresa të veçanta në Stamboll i la me patriotin Ismail Qemali. -Mbas kryerjes së studimeve në Stamboll, më pas i vazhdon ato në SHBA ku udhëheq e drejton nga afër edhe lëvizjen studenteske. Kështu më 1918, me iniciativën e tij, në SHBA themelohet "Lidhja e studentëve shqiptarë", drejtues i së cilës u zgjodh vetë ai. Njëherësh në SHBA ai meret edhe me veprimtari publicistike duke u zgjedhur editor i revistës "Studenti", ku shkruan një sërë artikujsh me frymë patriotike.

-Në vitin 1920 Skënder Luarasi kthehet në gjimnazin e Tiranës. Atdhe ku shërben për dy vjet rresht si nëpunës e të tij, e pse në shumë mësues në Kryqin e Kuq Amerikan në qytetin e Elbasanit. Skënder Luarasi, përkundrazi, -Si zëdhënës i aspiratave liridashëse e demokratike të masave e si demokrat i vërtetë që ishte, Ai mbështeti fuqimisht lëvizjen demokratike të viteve 1920-1924, duke përkrahur pa rezerva Qeverinë Demokratike të Nolit. Madje, në kohën kur po përgatitej rrëzimi i saj, ai së bashku me të vëllanë Dhimitrin, rreshtohen në forcat vullnetare të Kolonjës në mbrojtje të saj. -I etur për dije e kulturë, më pas ai vazhdon studimet në Austri, ku përfundon në vitin 1930 Fakultetin e Filozofisë të Vjenës. Edhe në Austri, Ai shquhet për veprimtarinë e tij atdhetare me sens të theksuar demokratik, duke u zgjedhur kryetar i shoqatës "Albania" dhe "editor i revistës Djalëria". -Pas përfundimeve të studimeve në Austri, Ai kthehet në Atdhe për të vazhduar më tej veprimtarinë e tij atdhetare në fillimisht punon si mësues i gjuhës shqipe, anglishtes e gjermanishtes në shkollën teknike Amerikane në Tiranë, më pas në shkollën tregtare të Vlorës, gjimnazin e Tiranës, në atë të Shkodrës e në vitin shkollor 1935-1936

transferohet përsëri në gjimnazin e Tiranës. Këto lëvizje të shpeshta të tij, e pse në shumë raste të motivuara politikisht, nuk e trembin profesor Skënder Luarasi, përkundrazi, zgjuan tek ai energji të reja për t'iu përkushtuar më shumë çështjes kombëtare. -Më 12 dhjetor të vitit 1936, Ai është i pari shqiptar i nisur nga Shqipëria, për në luftën antifashiste të Spanjës, për mbrojtjen e tij në shërbim të luftës së drejtë të popullit spanjoll për liri, me bindjen se, ashtu luftohej edhe për lirinë e Shqipërisë. -Në dhjetor të vitit 1945, për meritat e tij, populli i Rrethit të Kolonjës e zgjedh deputet në Asamblenë Kushtetuese. Në takimet e shumta që mori me popullin e krahinës së vet, ai mbeti luftëtar dinjitoz për vendosjen e një regjimi demokratik në Shqipëri, duke qënë përherë kundërshtar i vendosur i diktaturës që po instalohesh në Shqipëri. Gjatë kësaj periudhe Ai jep një kontribut të vyer për vlerësimin e figurave të Rilindjes Kombëtare të Kolonjës dhe evidencimin e vlerave kulturore e artistike të kësaj treve. -Gjatë viteve 1945-1982, ballazi e me guxim, ai i kundërvihet me të gjitha mënyra diktaturës, duke kundërshtuar luftën e klasave e duke mbrojtur me argumente shkencore të vërtetat histo-

rike. Gjatë gjithë kësaj periudhe Ai, si dhe më parë, pati për tabu të vërtetën e vetëm të vërtetën, duke mbrojtur kurdoherë e me pasion mendimin e fjalës së lirë. Për këto mendime e qëndrime politike zyrtare e kohës nuk vonoi ta etiketojë si "avokat të Sejfulla Malishovës", "historian borgjez arivist" etj, etj... -Me vlera të veçanta është krijimtaria e tij si shkrimtar e publicist, si lëvruer i apasionuar i gjuhës shqipe e shprehjes poetike shqiptare, studimeve historike, e sidomos, puna pasionante për përkthimin e disa prej kryeveprave botërore. -Skënder Luarasi, gjatë gjithë jetës së tij, ka qënë një ndër ato figura që ka mbrojtur me dinjitet e vendosmëri bindjet e tij demokratike, duke qënë vazhdimisht superior në sensin e së vërtetës, deri sa vdiq më 27 prill të vitit 1982.. Për punën e tij në dobi të kombit e Atdheut Ai është vlerësuar me dekoratën: "Mësues i merituar", "Punonjës i shquar i shkencës", me Urdhërin e Flamurit, "Për veprimtari patriotike të klasit të I-rë", me titullin e lartë "Nderi i Kombit", "Qytetar Nderi" i qytetit të Ersekës.

Aleks Gjergo
Ersekë, 19 janar 2010

Letërsi

Tregim:

BUKUROSHET

A.P.ÇEHOV

(Pjesa e parë)

Më kujtohet se, kur isha ende gjimnazist në klasën V apo të VI, udhëtova së bashku me gjyshin nga fshati Bolshoi Krepkoi, i krahinës së Donit, për në Rostov mbi Don. Ishte një ditë gushti me zagushi, drobitëse dhe e mërzitëshme. Nga vapa dhe thatësira, por sidomos nga era e nxehtë dhe e thatë, më lotonin sytë dhe më thahej goja, rrija sy mbyllur dhe s'ma kishte ënda as të sodisja, as të flisja e as të mendoja, madje edhe kur karocieri i përgjumur, ukrainasi Kapro, duke u matur të kamxhikonte kalin, ma fshikulloi padashje kapelën, nuk u ndieva, vetëm sa u përmenda nga përhumbja që e pashë i trishtuar, u tulata edhe më i përkorë, e treta larg shikimin, për të shquar përmes pluhurit dhe duhmës mos dukej gjë fshati. Ndalëm në fshatin e madh armen Bahçi-Sallah, te një pasanik i madh, një i njohur i vjetër i gjyshit, për t'i dhënë tagji kalit. Nuk kisha parë kurrë në jetën time njeri më të shëmtuar se ky armeni. Përfytyroni një kokë të vogël, të qethur, me vetulla kaleshe e të dendura, që i vareshin poshtë, me hundën si sqep zogu, me mustaqe të mëdha e të thinjura, me gojë vesh më vesh, që mbante të shtrënguar fundin e çibukut të gjatë, punuar në dru qershie; ajo kokë sa një dardhë dukej si e vënë me dorë në trungun e gërmuqur dhe ngordhalaq, të veshur me një kostum fantastik: xhaketa ishte e ngushtë dhe e kuqe, kurse shallvaret i kishte të gjera dhe bojëqielli. Qënia e çuditshme ecte me këmbët hapur, i tërhiqte zvarrë pandoflat, fliste pa e hequr çibukun nga goja, kurse mbahej më të madh për të treguar krenarinë armene: s'i qeshte buza, zgurdullonte sytë dhe ndaj miqve përpiquej të tregohej sa më pak i vëmendshëm. Në dhomat e armenit nuk frynte era, as pluhur nuk ndieje veten mirë, ndiheshe si në strepën e hapur e në rrugë, ngaqë ishte zagushi dhe të kaplon mërzia. Më kujtohet si u tërhoqa në një qoshe, u ula në një syndyk të gjelbër, ashtu siç isha, i mbuluar më pluhur dhe i kapitur nga rruga. Muret e drurtë e të pa lyer, mobiliet e punuara trashë dhe dyshemeja e shtruar me dërrasa të pazdruguara lëshonin erë druri të

tharë nga dielli. Ngado që të hidhje sytë shihje miza, miza, miza... Gjyshi me armenin bisedonin me zë të ulët për kullotat, për dhentë dhe për miellin e thekrës... E dija që samovari do të ishte gati pas një ore, pastaj do të binte të flinte nja dy a tre orë, pra, do të më ikte gjysma e ditës në pritje dhe pas kësaj më priste përsëri vapa, pluhuri dhe rruga e pashtuar. Tek dëgjoja mërmërimën e të dy zërave, po më dukej sikur armenin, surgjenët me enë, mizat, dritaret, që përvëlloheshin nga dielli saç, i kisha parë prej kohësh dhe do të vazhdoja ti shihja gjatë, deri në një të ardhme shumë të largët, dhe kjo në shpirt mu përvodh urretjtja për stepën, për diellin, për mizat...

Shërbëtorja me shami në kokë sollti takëmin e çajit, pastaj samovarin. Armeni u ngrit përtueshëm, doli në hajat dhe thirri:

-Mashja! Hajde na shtjer çajin! Ku je, Mashja?

U dëgjua hapa të nxituara dhe në dhomë hyri një vajzë rreth gjashtëmbëdhjetë vjeçe, e veshur me fustan basme dhe me shami të bardhë në kokë. Kur po shpëlante gotat dhe po i mbushte me çaj, më qëndronte me shpinë, më ra në sy vetëm që e kishte të hollë belin, ishte zbathur, kurse thembrat e vogla lakuriqe ia mbulonin çitjanet e gjata.

I zoti i shtëpisë më ftoi për të pirë çaj. Kur po ulesha në tryezë, ia hodha sytë fytyrës së vajzës që më zgjati gotën dhe befas ndjevva flladin përtëritës të ma freskojë shpirtin dhe të m'i largojë përshtypjet gri të asaj dite të zymtë, sëbashku me mërzinë dhe pluhurin. Më mahnti fytyra e saj e mrekuillueshme, me tipare të spikatura, kurrë ndonjëherë s'më kishin zënë sytë një bukuri të tillë, madje as në ëndërr nuk më qe fanitur. Para meje qëndronte e bukura e dheut, vajza me një vesk të veçantë dhe përshtypja që më bëri ishte e ngjashme me vetëtimën kur shkrep.

Jam gati të betohem për ç'kam më të shtrenjtë, që Mashja, siç e thërriste i ati, ishte vërtet e bukura e dheut, por ja që nuk di si ta vërtetoj. Se ndonjëherë ndodh qe sheh re të hallakatura, të çrrëgullta në horizont, sheh diellin të fshihet pas tyre, sheh rrezet që i zbukurojnë edhe ato, edhe qiellin, duke i larushuar me

ngjyra të çuditshme: herë bojë allë e herë portokalli, herë në të artë e herë në lejla, por ndonjëherë dhe në rozë të shpëlarë; she që njëra re ngjan si murg, tjetra si peshk, ndërsa e treta si turk me çallmë. Vë re që perëndimi i përflakur pushton një të tretën e qiellit, rrezëllin në kryqin e kishës, shndrin në xhamat e shtëpive, vezullon lëbyrshëm në sipërfaqen e lumit dhe dridhet nëpër drurë; diku larg, në sfondin e perëndimit të përflakur fluturon një tufë patash të egra, që shkon për ta kaluar diku natën... Edhe bariu me lopët përpara, edhe gjeometri që rrugëton në koloshinë mbi digë, edhe zotërinjtë që shëtisin, qe të gjithë, vështronjë perëndimin, që të gjithë deri në një e gjejnë tejet të bukur, por asnjë nuk di të thotë dhe s'e thotë dot se ku qëndron bukuria.

Nuk isha vetëm unë që mbeta i mahnitur nga bukuria e armenes. Gjushi im, plakushi tetëdhjetëvjeçar, njeri i prapë dhe shpërfillës i seksit të dobët dhe i bukurisë së natyrës, s'po ia ndante shikimin ledhatues Mashjes më tepër se një minutë dhe e pyeti të zotin e shtëpisë:

-Kjo, vajza juaj është, Avet Nazariç?

-Ime bijë... Vajza ime është...-iu përgjigj ai.

-Vajzë për kokën e vajzës qënka, e mburri gjyshi.

-Bukurinë e Armentes piktori do ta cilësonte klasike dhe të rreptë. Ishte një e tillë bukuri, që kur e sodit, një zot e di përse, ndjen brenda vetes siguri, je i bindur se sheh tipare të rregullta, se flokët, sytë, hunda, goja, qafa, gjoksi dhe të gjitha lëvizjet e trupit njomëzak e të hajthmë janë të shkrira në një të tërë harmonike, bindesh se natyra me asnjërin prej tyre nuk ka gabuar, të duket se gruaja me bukuri ideale duhet të ketë pikërisht një hundë, si kjo e mashjes, të drejtë pak me kuriz; të tillë sy të zinj, të mëdhenj, të tillë flokë të zinj, kaçurrelë dhe vetulla e qerpikë si këta, që i shkojnë aq shumë bardhësisë delikate e të mermertë të ballit dhe të faqeve, siç i shkon kallami i gjelbër kaltërsisë së lumit të qetë, qafa e bardhë e Mashjes dhe gjoksi vajzëror, ishin ende të pazhvilluara, por per t'i derdhur në mermer ju duhet vetëm pak talent krijues. E shihni t'i thënë dy fjalë jashtëzakonisht të këndshme dhe të sinqerta e të bukura, të tilla që do ti shkonin shumë përshtat.

Në fillim e ndjeva veten të fyer dhe të turpëruar që Mashja s'po më kushtonte vëmendje, që tërë kohën i mbante sytë poshtë; po më dukej se një shtresë e veçantë ajri, e lumtur dhe krenare, më ndante prej saj dhe ma largonte me xhelozin nga sytë. "Ngaqë më ka mbytur pluhuri, më ka përcëlluar dielli, por edhe ngaqë jam ende çunak, prandaj ndodh kështu,"-e qetësova veten.

Desha s'desha e pashë veten të përpirë nga joshja e saj e veçantë. E harrova mërzinë e stepës, pluhurin e rugës, s'e dëgjoja më zukatjen e mizave, por as shijen e çajit nuk po e vija re, vetëm ndjeja që përballë meje, në anën tjetër të tryezës, qëndronte një vajzë e bukur.

Bukurinë që kisha përpara e ndjeja në mënyrë të çuditshme.

Mashja nuk më zgjonte as dëshirë e as entuziazëm, as kënaqësi e as gëzim, por vetëm trishtim, një trishtim ndrydhës, ndonëse të këndshëm. Nuk ishte fort i papërcaktuar, por i vagullt ishte, si në ëndërr. Nuk e di përse më vinte keq edhe për veten, edhe për gjyshin, edhe për armenin, por edhe për armenkën, dhe po më dukej sikur të gjithë, që të katërt, kishim humbur diçka të rëndësishme dhe të nevojshme për jetën tonë, dhe kurrë nuk do të mundnim ta gjenim. Edhe gjyshi i varri kryet i trishtuar. Nuk fliste më për kullotat e as për dhentë e për miellin e thekrës, vetëm heshte dhe e vështronte Mashjan i menduar. Pas çajit gjyshi ra të flinte, kurse unë dola në hajat. Shtëpia, ashtu si të gjitha shtëpitë në Bahçi-Sallah, ishte në shullë; nuk mbrohej as nga drurë e as nga tenda, nuk të zinte syri hije. Oborri i madh ishte i mbuluar nga bari i egër dhe nga shpëndrat e fjeri, sadoqë ishte vapë e madhe, prapë kishte gjallëri e vlonte hareja. Prapa njërit gardh, sepse oborri e madh e ndanin disa gjerdhe, po shinin grurin. Përreth strumbullarit të ngulur në mesin e lëmit vraponin revan dymbëdhjetë kuaj të lidhur krah njëritjetrit sërë, që dukeshin si një erashkë e madhe. Përbri ecte në një hap me ta ukrainasi, veshur me këmishë të gjatë dhe me shallvare të gjera, që u grahte dhe i trembte me kamxhik, u hakërrohej dhe u trimërohej si të donte t'u tregonte pushtetin e vet.

-Haj-haj-haj!... A-a-a... të mallkuar! Ju hëngërt kolera, ju hëngërt!

Kuajtë, disa kuqalashë, disa vracë e disa kërrë, ngaqë s'e merrnin vesh përse i detyronin të silleshin ashtu rrotull në një vend dhe të shkelnin kalinjtë e grurit, vraponin pa qejf, si të bënë punë angari, dhe ashtu të fyer tundnin bishtin. Që poshtë patkonjëve të tyre era ngrinte lart re të arta byku dhe i shtynte matanë gardhit. Pranë kavalave me duaj, që prisnin radhën të shiheshin, kishte gra me cfurqe ndër duar, shkonin e vinin qerret, kurse më përtej, në oborri tjetër, rendnin revan, përqark një strumbullari një dyzinë tjetër kuajsh dhe një ukrainas tjetër u grahte me kamxhikun e gjatë në dorë dhe seç u fliste.

Shkallët ku isha ulur të përvëltonin nga dielli i nxehtë, parmakët e lyer vetëtinin nga boja e shkrirë, edhe në kornizat e dritareve dukeshin bulëza boje të shkrirë dhe rrëshirë, nën parmakët dhe nën grilat e dritareve, në vendet në hije, dukeshin të ngjeshura pranë njëta-tjetrës pikëlat e bojës së ngurtësuar. Dielli më përvëlonte kokën, gjoksin, qafën dhe shpinën, por s'po e vija re, vetëm ndjeja që prapa meje, në hajat dhe në dhoma, fërkoreshin këmbët e saj të zbathura. Pasi e lau dhe vuri në vend takëmin e çajit, Mashja u lëshua me vrap nëpër shkallë, më flladiti me ajrin që trazoi në vrull e sipër dhe si shpend krahëshkruar fluturoi për te baraka e vogël që, me sa dukej, ishte kuzhina; që andej vinte kundërmimi i dashit të pjekur dhe dëgjoheshin klithma qortuese në gjuhën armene. Ajo u zhduk prapa derës së nxirë të kuzhinës dhe aty ku kishte qënë kuzhinës dhe aty ku kishte qënë ajo u duk një armene plakë, kurrizdalë, me fytyrë të skuqur dhe me çitjane jeshile. Plaka ishte me xhinde, dike shante. Pas pak në pragun e guzhinës u duk përsëri Mashja, e kuqe flakë nga zjarri i sobës me një tepsitë të madhe me bukë të zesë në sup; me trupin e epur bukur nën peshën e bukës, vrapoi mes për mes oborrit për në lëmë, kaloi nëpër deriçkë, u zhyt në retë e arta të bykut dhe u fsheh prapa qerreve. Ukrainasi që ngiste kuajt e hodhi mënjane kamxhikun, pa i heshtur andej nga ishin qerret, e vuri re armenen me bukën në sup, e shoqëroi një copë herë me sy dhe si të ishte i

hidhëruar nga ajo që po i shihnin sytë dhe pas gjithë kësaj iu hakërrua kuajve:

-Mjaft, de, ju hëngërt dreqi, ju hëngërt! Të paudhë!

Kurse unë tërë kohën mbaja vesh dhe dëgjoja fërfërimën e butë të këmbëve të saj të zbathura, e shihja tek sillej poshtë e lart nëpër oborr, kurse fytyra i shprehte seriozitet e merak. Herë vraponte nëpër shkallë duke më flladitur ëmbël, herë shkante në kuzhinë, pastaj në lëmë, dilte nga porta, kthehej, dhe të gjitha i bënte me shpejtësi aq të madhe, saqë mezi arrija ta ndiqja.

Dhe sa më shpesh vezullonte në sytë e mi bukuria e saj, aq më shumë më shtoej trishtimi. Më dhimbsej vetja, ajo, ukrainasi, që s'linte rast ti shpëtonte pa e shoqëruar me sytë e trishtuar, kur zhytej në retë e arta të bykut e pastaj dilte e u afrohej qerreve. Mos ishte zilia për bukurinë që kisha apo ishte keqardhja që një bukurroshe si ajo nuk më përkiste dhe kurrë nuk do të bëhej imja, kurse unë për të isha një i huaj apo e ndjeja turbull, se bukuria e saj aq e veçantë ishte rastësi dhe e panevojshme dhe si çdo gjë mbi dhe nuk ishte e përjetshme, apo, ndoshta, trishtimi që më kishte pllakosur ishte i llojit të veçantë, ishte nga ato që i zgjohet njeriut sa herë që kundron një bukuri të vërtetë? Një Zot e di!

Tri orët që prita kaluan pa u vënë re. Më dukej se nuk isha ngopur së pari Mashjen, e pra, Karpoja kishte qënë në lumë, e kishte freskuar kalin dhe po e mbrehte. Kafsha e lagur shkroftinte e kënaqur dhe rihte më këmbë tokën. Kaproja i bërtiste: "Bëj prapa!" U afrua gjyshi. Mashja na hapi portën, u dëgjua kërkëllima e menteshave, hipëm në karrocë dhe dolëm nga oborri. Bëmë një goxha rrugë të heshtur, dukeshim si të zemëruar me njëri-tjetrin.

Pas dy orësh rrugë, përsëlargu u duk Rostovi dhe Nahiçevani. Karpoja, që tërë kohën kishte heshtur, u kthye vrulltas me fytyrë nga ne dhe tha:

-Ama vajzë për kokën e vajzës kishte armeni!

Dhe i ra kalit me kamxhik.

Përkthyer nga:
Jorgji Doksani

MOZAIK



PËRSOSMËRIA E BUKURISË SË GRUAS

-Një grua që të jetë
përsosmërisht e

bukur, duhet të ketë 30

cilësitë që pasojnë dhe

që përbëjnë:-

BUKURINË IDEALE

të formës femërore, siç

thuhet që ka qënë ajo e

Helenës së Trojës:-

3 të bardha:-lëkura-
dhëmbët-duart

3 të zeza:-sytë-vetullat-
qepallat

3 të kuqe:-Buzët-faqet-
thonjtë

3 të gjata:-trupin-flokët-
qepallat

3 të gjera:-Gjoksi-ballin-
vithet

3 të ngushta:-gojën-belin-
qafën

3 të trasha:-krahët-
pulpat-këmbët

3 në formë harku:-trupin-
hundën-vetullat

3 të rrumbullakta:-
gjinjtë-qafën-mjestrën

3 të vogla:-këmbët-
duart-veshët

MJEKESIA POPULLORE:

-Çfarë çajra duhen pirë për të mos patur KOLLË



Lule bliri:

(3-4 gota në ditë)

Fieri i gurit:-

1 gotë çdo mëngjes
(ëmbëlsoje me 1/2
lugë kafeje mjalti
original)

Çaji i lulëkuqes

(petalet e thara) 1/2
gotë me ujë 30
minuta lihen, pihet

1/3 e lëngut e ëmbë-
lsuar 1/2 lugë kafeje

mjaltë (original)

Lëngje frutash

(2-3 litra në ditë)

Çokollata

Lëngu i

gështenjës

i ëmbëlsuar me
mjaltë (original)

VAKSINIMI-

mënyra e vetme
për të parandaluar
GRIPIN!

Përdorni:

Karamelet e

MENTOLIT

kundër djegies së
fytit.

Gazeta e Pavarur Rajonale "Korça"

-Ofron shërbime publicistike në faqet e saj si: Reklamacione-Njoftime-Oferta shitblerje shtëpish, dyqanesh, trojesh, objekte, e produkte të ndryshme, etj.

-Ajo fton të gjithë qytetarët, biznesmenët, OJF-të (për Projektet), institucionet shtetërore e private brenda dhe jashtë vendit.

-Efektiviteti i këtij shërbimi publicistik është shumë i madh, sepse Gazeta "Korça" shpërndahet me shërbimin postar në komuna, bashki, si dhe në fshatra, institucione e biznese në Qarkun e Korçës, dhe në shitje të lirë.

-Ajo mund të lexohet në të gjithë botën, nëpërmjet internetit, mjafton të klikoni: www.gazetakorca.com

Redaksia!

Jeni të mirëpritur!



OFERTË SHITJE MAKINE

Shitet një makinë e cilësisë së

lartë-bashkëkohore-

marka "Mitsubishi" (japoneze),

prodhim USA

ngjyrë e bardhë.

-Jeni të mirëpritur!

Për të luftuar GRIPIN

HUDHRA-ka fitoncide për ngordhjen e mikrobeve virusale. 4-5 thelpinj hudhra qërohen, grihen dhe bashkohen me vaj ulliri dhe kos.

MJALTI (original) (2 lugë çaji në ditë)

LAKRA e freskët ose e zjerë, jo turshi (arme)

MANAFERAT:-Ngrënia e tyre të freskëta, kur është pjekur fruti (i zi)

Çaji i malit:-2-3 gota në ditë i ëmbëlsuar i shoqëruar me feta limoni dhe me mjaltë.

**-Përdorimi i këtyre ushqimeve
ju mbron nga gripi**

**-Karota-spinaqi-speci-mashurkat-bizelet-
mandarina-portokalli-e verdha e vezës-
lakra-lëngu i mollës-pula (supë)-mishi i
lopës-peshku-sardelet (jo të shoqëruara
me bulmetra, se tek disa njerës krijon
intoksikacion)**

-Më 13 dhjetor
2009, në lokalin

"Anxhelo" Korçë u shoqatës atdhetare-
zhvillua Analiza kulturore "Gora"-në
vjetore e punës të Tiranë **Z.Besim Shyti**.
kësaj shoqate.

-Më pas u mbajt
-Merrnin pjesë anë- Raporti nga kryetari i
tarë të shoqatës, e të Shoqatës "Gora"-Dega
ftuar të tjerë. Korçë - **Z.Selami**

-Në fillim u lexua **Kreka**, i cili evidentoj
Përshëndetja e dër- punën e bërë, pro-
guar nga kryetari i blemet që kanë dalë

Shoqata atdhetare-kulturore "GORA"-Dega "Korçë"



dhe detyrat për të
ardhmen. Në mble-
dhje e morën fjalën
dhe diskutuan: Mitat
Lushnjari-Demir
Musollari-Ahmet
Xhipo-Shkëlqim
Taipllari - Juli Kodra,
etj. -Më pas u bënë
zgjedhjet:-Këshilli i

Shoqatës prej 17
veta-kryesia 9 veta.

-Kryetari i Shoqatës
Atdhetare-Kulturore
"Gora" - Dega Korçë
u zgjodh:-

Z.Mitat Lushnjari -
Ish Kryetar **Z.Selami**
Kreka u zgjodh
Kryetar Nderi.

-Për të pranishmit u
shtrua një drekë.

Ramadan Dinoshi

MBRETI I EGJYPTIT



Mehmet Ali Pasha

MEHMET ALIU-Mbret punë e rrallë dhe e çudi- i parë i dinastisë së tshme në historinë e Shqiptarëve në Egjipt. botës, është një varg Ka lindur në Zëmlak të triumfesh të papreme, një Korçës në vitin 1769. rradhë fitimesh të luftës e Familja e tij e hershme u të diplomacisë prapa të shpërngul në Kavalla të cilave mbetet i habitur Greqisë (qytet i ndërtuar historiani.”Më 2 gusht nga Aleksandri i Maqedonisë të Greqisë). Në Aleksandri. Egjipt shkoi ushtar i -Arkivoli i tij u përcoll nga thjeshtë i Portës së 22 sheikë... Lartë, por shpejt u bë -Gjenerata e nipërve të tij komandant, Pasha. Ai ka udhëhoqën Egjiptin deri qënë dhe Guvernator në në vitin 1952. Kretë. Mehmet Ali Mbreti Faruk ishte i udhëhoqi Egjiptin drejt fundit i dinastisë së përparimit, pavarësisë, Mehmet Aliut. shtetkrijimit dhe krijoi Më 18 qershor 1953- dinastinë mbretërore Qeveria revolucionare shqiptare, pamvarisht shfuqëzoi zyrtarisht se nuk dinte të shkruante Monarkinë, duke i dhënë dhe të fliste tjetër gjuhë fund 148 vjetve të sundimit të Dinastisë së përveç shqipes. shqiptarit Mehmet Ali Prof.Aleksandër Xhuvani në librin e tij shkruan:- pashës në Egjipt. ”Gjithë Mbretëria e Mehmet Aliut është një

A.B

KURIOZITETE

Në DUBAI-përurohet ndërtesa më e lartë në botë
“BURJ DUBAI”


-800 metra lartësi
-Nga 95 km-mund të shihet maja e ndërtesës
504 metro-ngritja me ashensorin kryesor
57-numri i ashensorëve
49-numri i kateve për zyra.
1044-numri i apartamentëve të banimit
280 metro gjatësia e shatërvanit në katin e parë të kullës, më i gjati në botë.
28.261-numri i paneleve të xhamit që mbulojnë fasadën.

L.F

Burj Dubai



Libra të rinj:



...Po, tek ju i morëm dhe tek ju po i sjellim përsëri...

Duke lundruar në internet dhe duke lexuar disa media të ndryshme, vemë re se po i kushtohet gjithmonë dhe më shumë rëndësi “vipave” që më së shumti nuk e përmbushin me vlerat e tyre intelektuale dhe morale statusin e njeriut të dëgjuar, të mirënjohur në publik. Dhe po lihen ndoshta në harresë, në sajte të panjohura ata njerëz me mijra dhe me mijra, që jetojnë dhe punojnë e krijojnë ndershmerisht nëpër dekada. Këta njerëz me familje “të panjohura” janë në fakt ato qeliza të shoqërisë që e kanë krijuar dhe e krijojnë çdo ditë me djersë dhe punë historinë e përditshme njerëzore.....

Z.A

REDAKSIA

Botuesi:

VEHBI FURXHI

Art Design:

L.Furxhi

Drejtores: Laura Furxhi

Aurel Grabocka-Drejtor i ARZH-së Korçë

Bardhi Sejdarasi-Tiranë-Ylber Merdani-poet,

-Skënder Demolli-(Athinë)-Mevisa Isallari (Berlin-Gjermani)

Arben Caka-Kolonjë, Mihal Kuteli – Pogradec,

ADRESA:

Rr. „Misto Mame“
Nr. 13, Korçë

Tel:

082242985

Cel:

0682459546

Shtypshkronja

„Kotti“

Adresa:

Rr. „Jovan Kosturi“

Nr.1

Korçë

Tel: 082242382